

SYLLABUS i Lëndës: "E Drejta Kolektive e Punës"

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Kolektive e Punës
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	<i>Vendi ku caktohet nga menagjmenti i Fakultetit Juridik të UP-së</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Hava Ismajli
Detajet kontaktuese:	044-655-400
Përshkrimi i lëndës	Lënda "E Drejta Kolektive e Punës" si lëndë obligative në studimet Master, ka përmbajtje të tillë që studentëve u mundëson fitimin e njohurive më të gjëra dhe më komplekse nga fusha e mardhanjeve Kolektive të Punës. Në këtë kontekst studentët nuk do të kenë kufizime që njohuritë e tyre ti kufizojnë, por ata do të jenë të lirë që të hulumtojnë në mënyrë vetanake, për faktin se studimet master konsiderohen si studime më specifike.
Qëllimet e lëndës:	Përgaditja dhe aftësimi i studentëve për gadishmërinë e tyre që në të ardhmën të jenë të përgaditur për dallimin në mes të mardhënjeve individuale dhe mardhënjeve Kolektive të Punës, raportet në mes të këtyre dy mardhënjeve si dhe rrolin e sindikatës në mbrojtjen e interesave ekonomike dhe sociale të puntorëve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të ligjëratave nga kjo lëndë, studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> <u>1. Të aftësohet për interpretimin e dispozitave juridike nga kjo fushë:</u> <u>2. Të njihet më për së afërmi me raportet në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe ndikimet:</u> <u>3. Të njoftohen për të drejtat dhe obligimet e punëtorëve që përcaktohen me Kontratë Kolektive:</u> <u>4. Të përcjellin ndryshimet e raporteve në mes të palëve industriale (punëdhënësve dhe punëmarrësve), si</u>

	<p><u>dhe të njihen me rrolin e dialogut social në zhvillimet ekonomike dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve në pozitën ekonomike të punëtorëve:</u></p> <p><u>5. Të jenë të gatshëm që t'i përdorin njohuritë teorike dhe praktike me qëllim të zhvillimit të negociatave kolektive dhe lidhjen e Kontratave Kolektive të Punës:</u></p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	14 javë	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14 javë	14
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5		5
Ushtrime në teren	1	1 javë	1
Kollokfiume,seminare	4	1 jave	4
Detyra të shtëpisë	5	1 jave	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14 javë	28
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1 jave	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1	3
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			91

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Në nivelin e studimeve Master, ligjeratat kryesisht do të mbahen në formë interaktive dhe nuk do të trajtohen vetëm çështjet e përcaktuara në planin e dizajnuar, por do të trajtohen edhe çështje të tjera për të cilat janë të interesuar studentët, e poashtu edhe çështjet të cilat do të jenë aktuale në momentet reale.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punimet seminarike, studentët do të kenë mundësi të përcaktohen për ndonjë temë, për punim seminarik para fillimit të punës, atyre iu ipen udhëzime se si duhet të përgatitet punimi seminarik. Punimin seminarik studenti duhet t'ia dorëzoj mësimdhënësit, i cili e kontrollon dhe pas kontrollimit hapën diskutime me studentë lidhur me temën e seminarit. - Ushtrimet me grupe më të vogla –
-------------------------------------	---

	<p>gjatë mbajtjes së ushtrimeve studentëve do t'iu mundësohet që të jenë më aktiv si dhe t'i shprehin opinionet dhe idetë e tyre për zgjidhjen e çështjeve nga fusha e mardhënjeve kolektive të punës.</p>	
Metodat e vlerësimit:		
Prezantim dhe puna grupore 20 % Prezantim Individual: 5 % Aktiviteti: 10 % Punim seminarik:15 % Provim përfundimtar:50%	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
	91-100	10 (dhjetë)
	81-90	9 (nëntë)
	71-80	8 (tetë)
	61-70	7 (shtatë)
	51-60	6 (gjashtë)
Literatura		
Literatura bazë:	Dr.Hava Bujupi-Ismajli, E drejta e punës, Prishtinë, 2014 Dr.Hava Bujupi-Ismajli, E drejta ndërkombtare e punës, Prishtinë, 2001	
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.dr.Kudret Çela, E drejta e punës I, Tiranë 2000 2. prof.dr.Kudret Çela, E drejta e punës II, Tiranë 200. 3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Qershor, 2008. 4. Ligji i Punës së Kosovës, Janar 2011. 5. Ligji i Punës i Republikës së Kosovës, Janar, 2012. 6. Karta sociale Evropiane e Ndryshuar , 1999. 7. .Ligji për dhënien e lejeve për punë dhe punësim të Shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. 8. Ligji për Grevat. 9. Ligji për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të puësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. 10.Kontratrat kolektive të lidhura në Republikën e Kosovës. 11.Sindikatat në shekullin 21 - (manual diskutimi për sindikatat në vendet në tranzicion) - Friedrich Ebert Foundation. 	

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
1	<ul style="list-style-type: none"> • E drejta kolektive e punës • Sindikatat • Organizimi Sindikal dhe të drejtat themelore të njeriut nga puna dhe lidhur me punën: • Konventa mbi liritë sindikale dhe mbrojtjen e të Drejtave sindikale: • Konventa mbi të drejtat e punëtorëve në organizim dhe negociata kolektive
2	<ul style="list-style-type: none"> • Sindikatat dhe roli i tyre në periudha të caktuara kohore. • Roli i sindikatave në periudhën e liberalizimit të hershëm. • Roli i sindikatave në periudhën e liberalizimit të vonshëm. • Roli i sindikatave në periudhën industriale. • Roli i sindikatave në shtetet me sisteme juridike bashkëkohore.
3	<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi dhe objekti i të Drejtës Kolektive të Punës. • Zhvillimi i të Drejtës Kolektive të Punës. • Kontratat e para Kolektive të Punës. • Roli i Kontratave Kolektive në të Drejtën Bashkohore të punës.
4	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata kolektive: • Nocioni dhe karakteristikat e Kontratave Kolektive: • Raporti i kontratës kolektive dhe kontratës mbi punës • Rëndësia e Negociatave kolektive dhe kontratave Kolektive: • Natyra juridike e kontratave kolektive.
5	<ul style="list-style-type: none"> • Organizata ndërkombëtare e punës (ONP-ja): • Themelimi: • Struktura organizative e ONP-së • Qëllimet dhe veprimtaria e ONP-së: • Konventat e organizatës ndërkombëtare të punës që i referohen të drejtave themelore nga puna dhe lidhur me punën:
6	<ul style="list-style-type: none"> • Sanksionimi i të Drejtës Kolektive të Punës me dispozita ligjore. • Legjislacioni i ri i punës në Republikën e Kosovës dhe roli i sindikatës dhe Kontratave Kolektive sipas këtij legjislacioni. • Inkorporimi i dispozitave të akteve ndërkombëtare në Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës lidhur me sindikatat dhe Kontratat Kolektive. • Dialogu Social
7	<ul style="list-style-type: none"> • Në javën e shtatë do të bëhet një ushtrim ku studentët do të ndahen në tri grupe, ku njëri do të përfaqëson Qeverinë, tjetri Punëdhënësin ndërsa grupi i tretë Punëmarrësin. Kjo me qëllim që të konstatoj se sa ata kanë njohuri për dialogun social si një proces demokratik i shkëmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit në mes të këtyre tri strukturave për zgjidhjen e çështjeve të caktuara e sidomos nga fusha e mardhënjeve të Punës.
8	<ul style="list-style-type: none"> • Negociatat në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve që i paraprinë lidhjes së Kontratës Kolektive; • Arritja e marrveshjes për lidhjen e Kontratës Kolektive; • Lidhja e Kontratës Kolektive.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
9	<ul style="list-style-type: none"> • Kontratat Kolektive të Punës sipas Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës. • Kontratat e përgjithshme kolektive të Punës. • Kontratat e veçanta Kolektive të Punës. • Kontratat Kolektive në nivel të Ndërmarrjes (Institucionit).
10	<ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtja e Kontratave Kolektive të Punës; • Raporti në mes të Ligjit, Kontratës Kolektive dhe akteve të përgjithshme; • Kushtet dhe mënyra e lidhjes së Kontratave Kolektive të Punës; • Kohëzgjatja e Kontratës Kolektive të Punës.
11	<ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e Kontratë Kolektive të Punës; • Raporti në mes të Kontratës Kolektive dhe Kontratës mbi Punën; • Dallimi i Kontratës Kolektive të Punës nga Kontrata Grupore e Punës.
12	<ul style="list-style-type: none"> • Çështjet që rregullohen me Kontratën Kolektive të Punës; • Kushtet dhe mënyra e themelimit të Mardhënjes së Punës; • Koha e Punës dhe sistemimi i punëtorëve në vendet e punës; • Pushimet; • Mbrojtja e punëtorëve në punë; • Pagat.
13	<ul style="list-style-type: none"> • Në javën e trembëdhjetë do të bëhet një ushtrim ku studentët do të ndahen në dy grupe, ku njëri do të përfaqëson Punëdhanësin kurse tjetri Puntorët (Sindikaten), dhe do të negociojnë për arritjen e marrveshjes lidhur me kushtet e Punës dhe të punësimit, çoftë në nivel të përgjithshëm aKjo me qëllim që të konstatoj se sa ata kanë njohuri për dialogun social si një proces demokratik i shkëmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit në mes të këtyre tri strukturave për zgjidhjen e çështjeve të caktuara e sidomos nga fusha e mardhënjeve të Punës.
14	<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet e presionit sindikal; • Greva; • Llojet e Grevave; • Karakteristikat e Gravave; • Mjetet e kundërpresionit sindikal; • Grevëthyesia; • "Lock-Out"-i, (mbyllja e Fabrikës);
15	<ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhja e konflikteve Kolektive; <ul style="list-style-type: none"> • me marrveshje; • me ndërmjetësim; • Gjykatave; • Arbitrazhit.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët gjatë ligjëratave, provimeve, por edhe pranisë tyre në fakultet, duhet t'i përmbahen rregullave si më poshtë:

- mos ta pengojnë procesin mësimor
- t'i respektojnë mësimdhënësit.
- Mos të përdorin pije, goma përtpypse, duhan, në sallë të mësimi.
- Ti ç'kyçin telefonat celular, gjatë ligjëratave dhe provimeve.
- Mos të kopjojnë gjatë mbajtjes së provimeve dhe testimeve.
- Të respektojë dispozitat e kodit të etikës, hyrë në fuqi në Tetor të vitit 2009, e të hartuar në bashkpunim me ABA-Rollin dhe USAID.